



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

E.Rev.nr.48/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Milena Deric, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses "Ndërmarrja Publike Banësore", me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V. K., kundër të paditurës "Dona Impex", me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ymer Bardhi, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti pagesë e borxhit në shumën e përgjithshme prej 33,766.01 €, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.355/19 të datës 08.03.2021, e pas marrjes së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastin KI36/23, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të paditurës "Dona Impex", me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.355/19, të datës 08.03.2021.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin I.EK.nr.624/2018, të datës 30.07.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka vendosur si në vijim: *"I Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Ndërmarrja Publike Banësore, me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet e paditura "Dona Impex", me seli në Prishtinë, që nga baza e kontratës mbi qiranë e lokalit afarist-depos, paditëses t'ia paguaj borxhin në shumën prej 33,766.01 €, me kamatë siç e aplikojnë bankat në Kosovë për mjetet e deponuara në afatin prej një viti, pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 18.05.2016, e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh duke llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale."*

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, me aktgjykimin Ae.nr.355/19, të datës 08.03.2021, ka vendosur që të refuzoj si të si e pabazuar ankesën e të paditurës "Dona Impex" me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.624/2018 të datës 30.07.2019, e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të pranoj revizionin e të paditurës, ashtu që aktgjykimet e goditura të prishen, respektivisht anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ose aktgjykimet e goditura të ndryshohen, ashtu që padinë e paditëses ta hedhë poshtë, ashtu që të paditurën ta liroj nga detyrimi i pagesës së borxhit.

Pala paditëse me përgjigje në revizion e ka kontestuar revizionin e të paditurës, me propozim që Gjykata Supreme, revizionin e të paditurës ta hedhë si të palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin E.Rev.nr.46/2021 të datës 10.11.2022 e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ae.nr.355/2019, të datës 08.03.2021. Ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, e paditura më datë 10 shkurt 2023, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar mbrojtje juridike, me pretendim se i janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin KI36/23, datë 28 tetor 2024, ka deklaruar të pranuar kërkesën, ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme E.Rev.nr.46/2021, datë 10 nëntor 2022 dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e gjykatës. Meqë rasti është kthyer në rivendosje në këtë gjykatë, Gjykata Supreme duke marrë për bazë çështjet e ngritura nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj dhe pas shqyrtimit të revizionit, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, “Ndërmarrja Publike Banësore” me datë 13.11.2006, ka paraqitur padi kundër të paditurës “Dona Impex”, me seli në Prishtinë, për pagesën e borxhit nga baza e kontratës mbi qiranë e lokalit afarist.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të lëndës ka gjetur se palët ndërgjyqëse me kontratën me numër 03/706/1, të datës 06.04.2005, kanë krijuar raport kontraktues nga kontrata për shfrytëzimin e lokalit afarist - depos. Paditësja si qiradhënës ia ka dhënë në shfrytëzim të paditurit lokalit afarist - depon, ndërsa e paditura si qiramarrës ka marrë detyrimin e pagesës së qirasë. Raportin kontraktues palët ndërgjyqëse e kanë vazhduar me kontratën e datës 03.04.2006, me kontratën e datës 27.08.2007 dhe me kontratën e datës 15.10.2009. Mbi bazën e kontratave të lartcekura pala paditëse, të paditurit ia ka dhënë në shfrytëzim objektin afarist depon, i cili gjendet në rrugën “Bill Klinton” në Prishtinë, ndërsa e paditura ka marrë detyrim pagimin e qirasë. Paditësja nga ky raport afarist ka lëshuar fatura, të cilat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga e paditura dhe e paditura ka bërë pagesën e pjesshme të faturave të pranua nga paditësja. Kjo gjykatë më tej ka theksuar se kontestues ishte fakti se pas vitit 2009, a ka ekzistuar raporti kontraktues në mes të palëve ndërgjyqëse. Pala paditëse ka pretenduar se raporti kontraktues është vazhduar në heshtje, ndërsa pala e paditur ka mbajtur qëndrimin se palët ndërgjyqëse raportin kontraktues e kanë përfunduar me kontratën e vitit 2009. Po ashtu pala e paditur ka mbajtur qëndrimin se vazhdimi në heshtje i raportit kontraktues, në rastin konkret nuk ka mbështetje ligjore.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të provave të lëndës, ka ardhur në përfundim se palët ndërgjyqëse, deri në vitin 2009, kanë qenë në raporte kontraktuese, nga kontratat e formës së shkruar për shfrytëzimin e depos. Nga vitit 2009, deri në vitin 2014, nuk ka pasur vazhdim me shkrim të kontratës në formë të shkruar, por nuk ka pasur as deklaram të përfundimit të raportit kontraktues nga asnjëra palë. Padiësja ka vazhduar me lëshimin e faturave në emër të shfrytëzimit të depos, për të paditurën. E paditura nuk ka kryer pagesa, por ka bërë pranimin e rregullt të faturave të lëshuara nga padiësja deri me datën 07.03.2014, kur e ka njoftuar padiësen se nuk e shfrytëzon depon. Pas këtij njoftimi, përkatësisht me datën 11.03.2014, padiësja e ka bërë mbylljen e depos dhe ka hartuar procesverbal lidhur me veprimin e ndërmarrë. Duke u bazuar në këto të dhëna gjykata ka ardhur në përfundimin se raporti kontraktues i qiradhënies në mes të palëve në procedurë ka vazhduar deri me datën 07.03.2014. E paditura e ka pasur mundësinë që të deklarohej për mosshfrytëzimin e lokalit afarist, përmes mospranimit të faturave, refuzimit të nënshkrimit të tyre, apo përmes deklarimit shprehimor tek pala padiëse se nuk e shfrytëzon lokalin afarist, ashtu siç e ka bërë këtë me datën 11.03.2014. Kjo gjykatë ka vlerësuar se objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike kontestimore ishte edhe lartësia e borxhit të mbetur nga e paditura. Padiësja ka prezantuar fatura të cilat janë të nënshkruara dhe të pranuar në mënyrë të rregullt nga e paditura. Nga faturat e prezantuara nga padiësja e të cilat i referohen periudhave kohore 05.02.2005- 05.02.2014, rezulton se borxhi i përgjithshëm i të paditurës ndaj padiëses është në shumën prej 33,766.01 €.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me lartësinë e borxhit ka angazhuar edhe ekspertin financiar z. Emin Plakaj, i cili ka punuar ekspertizën, e po ashtu ka dhënë sqarime shtesë në lidhje me këtë çështje. Në raportin përfundimtar të ekspertizës, eksperti ka theksuar se pala padiëse ka lëshuar fatura edhe gjatë periudhës sa palët nuk kanë pasur kontratë të shkruar siç janë vitet 2008, 2010, 2011, 2021, 2013 dhe 2014, ku vlera e faturave të lëshuara nga pala padiëse në emër të shfrytëzimit të qirasë është në shumë prej 93,503.36 €, sipas ekspertit pala e paditur i ka paguar një pjesë të këtyre faturave të pranuar dhe pagesat e kryera arrijnë shumën prej 59,736.38 €, ndërsa të pa paguara kanë mbetur faturat në shumën prej 33,765.98 €. Gjykata pasi ka vlerësuar ekspertizën, si dhe provat tjera nga shkesat e lëndës, ka ardhur në përfundim se borxhi i përgjithshëm i të paditurës ndaj padiëses është në shumën prej 33,766.01 €, andaj, e ka aprovuar kërkesëpadinë e padiëses dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte edhe pretendimi i të paditurës, e cila ka theksuar heshtja e tij ka nënkuptuar shkëputjen e kontratës dhe se nuk ka për detyrim kompensimin e qirasë për periudhën sa nuk kanë pasur kontratë të lidhur. Gjykata ka vlerësuar se lëshimi i rregullt i faturave nga padiësja dhe pranimi i faturave nga e paditura, ka efektin juridik të vazhdimit në heshtje të këtij raporti juridik - detyrimor. Pala e paditur e ka pasur mundësinë që të deklarohej me anë të deklaratës së thjeshtë se e ka shkëputur raportin kontraktues dhe se depon në fjalë nuk është duke e shfrytëzuar ashtu siç e ka bërë me datë 11.03.2014. Pretendimin e tij se përmes telefonit e ka njoftuar palën padiëse se nuk ka interes ta vazhdoj këtë raport kontraktues gjykata nuk e ka marrë për faktin se ka qenë vetëm deklarativ. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë është vendosur bazuar në nenet 17.1 dhe 262 paragrafi 1 të LMD-së, ndërsa për kamatë është aplikuar neni 277 i LMD-së. Për shpenzimet e procedurës është vendosur në bazë të nenit 463.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, ka refuzuar të pathemeltë ankesën, duke aprovuar vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe

të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, nënparagraf b), g), j), k) dhe m) të LPK-së. Kjo gjykatë ka vlerësuar se për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së. Gjikata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, respektivisht dispozitën nga neni 17 paragrafi 1 të LMD-së, ku është përcaktuar se: “pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Në rastin konkret palët kanë qenë në raport kontraktues, mirëpo e paditura nuk ka kryer plotësisht pagesat lidhur me borxhin e krijuar nga shfrytëzimi i depos, borxhi i mbledhur nga faturat e lëshuara por edhe i përmbledhur në kartelën analitike për periudhën 2005-2004 është në shumën prej 33,766.01 €. Andaj në bazë të këtyre dispozitave gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit në shumën e gjykuar. Ndërsa në dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 të LMD-së është përcaktuar se: “kreditore në raportin detyrimor është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë detyrimin në mënyrë të ndërgjegjshme”. Në rastin konkret rezulton se e paditura, duke mos e kryer detyrimin e tij që ka rrjedhur pagesa e çmimit për qiranë e papaguar nga shfrytëzimi i depos, i ka mbetur borxh paditëses shumën prej 33,766.01 €, me ç'rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësja e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Prandaj duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e detyrimit i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë i vlerësoi pretendimet ankimore të palës së paditur se është bërë ndryshimi i padisë dhe lidhur me të nuk ka vendosur gjykata, mirëpo këtë pretendim e vlerësoi si të pabazuar, sepse paditësja në seancën përgatitore të datës 18.05.2016 e ka bërë ndryshimin e padisë, ku lartësinë e kërkesëpadisë e ka mbështetur në faturat dhe dokumentet e tjera financiare, e po ashtu nga shkresat e lëndës është vërtetuar se seanca e parë dëgjimore - seanca përgatitore me palët në procedurë është caktuar për datën 18.05.2016 dhe e njëjta është mbajtur në mungesë të palës së paditur, pas konstatimit se është ftuar në mënyrë të rregullt. Me nenin 258 paragrafi 1 të LPK-së është përcaktuar se: *“Paditësja mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës së shqyrtimit kryesorë të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare”*, në këtë rast është lejuar mundësia e ndryshimit të padisë gjatë seancës përgatitore, pas asnjë përjashtim.

Gjikata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare, si dhe i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat pala e paditur është thirrur në revizion.

Pala e paditur, përkatësisht i autorizuari i saj në revizionin e paraqitur është thirrur në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga dispozita e nenit 182.1 dhe 182.2 nënparagraf

e), g), i), n) dhe o) të LPK-së, mirëpo shprehimisht nuk ka përmendur ku qëndrojnë këto shkelje dhe si kanë ndikuar të njëjtat në vendimmarrje nga gjykatat e instancave më të ulëta, përveç shkeljeve që i referohen mungesës së arsyetimit dhe kontradiktoritetit të aktgjykimit, ndërlidhur me nenin 2 paragrafi 2.1 dhe nenin 3 paragrafi 3.3 të LPK-së. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga e paditura dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë, ndërsa shkeljet tjera të pretenduara kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara duke vlerësuar se të njëjtat vetëm janë listuar si shkelje në mënyrë të përgjithësuar pa sqaruar konkretisht shkeljet. Në anën tjetër, pretendimet në revizion rreth mos vërtetimit të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike nga gjykatat e instancës më të ulët, kjo gjykatë në pajtim me nenin 214 paragraf 2 të LPK-së së ndryshuar, nuk i trajtojë fare, pasi që revizioni për këtë shkak nuk mund të paraqitet. Ndërsa meqenëse ka rezultuar se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale, si dhe nuk janë evidentuar shkelje të rregullave procedurale, atëherë në këtë rast edhe nuk mund të zbatohet dispozita e nenin 224 paragraf 2 të LPK-së.

Gjykata Supreme ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, duke vlerësuar se për detyrimin e të paditurës në kompensimin e borxhit në emër të qirasë së papaguar, të konstatuar në aktgjykim të shkallës së parë e të pranuar nga gjykata e shkallës së dytë, janë dhënë arsye të qarta dhe të mbështetura në prova të administruara, posaçërisht në përfundimet e nxjerra nga ekspertiza e financiare, dhe sqarimet e ekspertit në shqyrtimin kryesor të datës 11.07.2019, ku në mënyrë të qartë është konstatuar baza juridike dhe lartësia e borxhit, si rezultat i shfrytëzimit të lokalit afarist të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, e që është pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, rezulton se nga gjykatat e instancës më të ulët e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, nga ka rezultuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, në shumën e gjykuar prej 33,766.01 €. Nga faktet e provuara nga gjykatat e instancës më të ulët, rezulton se paditësja me të paditurën ka hyrë në raport kontraktues për shfrytëzimin e lokalit afarist - deposë me kontratën numër 03/706/1, të datës 06.04.2005, ku paditësja si qiradhënës ia ka dhënë në shfrytëzim të paditurës lokalin afarist - depon, ndërsa e paditura si qiramarrëse ka marrë detyrimin e pagesës së qirasë. Raportin kontraktues palët ndërgjyqëse e kanë vazhduar me kontratat e datës 03.04.2006, 27.08.2007 dhe 15.10.2009, mbi bazën e të cilave pala paditëse, të paditurës ia ka dhënë në shfrytëzim objektin afarist depon, i cili gjendet në rrugën “Bill Klinton” në Prishtinë, ndërsa e paditura ka marrë detyrim pagimin e qirasë. Në rastin konkret mes palëve ndërgjyqëse kontestues ishte fakti nëse pas vitit 2009 ka ekzistuar raporti kontraktues mes tyre.

Si rezultat i kësaj, kjo gjykatë vlerëson se me vet faktin se e paditura ka shfrytëzuar lokalin afarist, respektivisht se e njëjta deri më datë 07.03.2014, nuk e ka njoftuar paditësen se nuk e shfrytëzon depon, që nënkupton se mes palëve ndërgjyqëse ka vazhduar edhe më tej raporti kontraktues për shfrytëzimin e lokalit afarist - deposë, do të thotë se e paditura në rastin konkret ka për obligim pagesën e borxhit paditëses deri në momentin e njoftimit të paditëses për mosshfrytëzimin e këtij objekti, në shumën e cekur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë,

të vërtetuar edhe nga shkalla e dytë. Kjo në pajtim me dispozitën e nenit 596 paragraf 1 të LMD-së së vitit 1978, që ka qenë në fuqi në momentin e vazhdimin të raportit juridik në mes këtu palëve ndërgjyqëse, e cila shprehimisht ka përcaktuar se: *“Kur pasi të ketë kaluar koha për të cilën është lidhur kontrata e qirasë qiramarrësi vazhdon ta përdorë sendin, ndërsa qiradhënësi nuk e kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontratë e re e qirasë me kohëzgjatje të pacaktuar, në të njëjtat kushte sikundër edhe në ato paraprake”*. Si rrjedhojë, nga interpretimi i kësaj dispozite, lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykatat e instancës më të ulët, rezulton se në rastin e palëve ndërgjyqëse janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore për tu konsideruar se këta të fundit e kanë vazhduar në heshtje kontratën e qirasë së vitit 2009, duke krijuar raporte reciproke ndaj njëri tjetrit, përkatësisht qiradhënësi ja lë në shfrytëzim depon qiramarrësit, ndërsa ky i fundit edhe ka detyrimin që të paguajë qiranë në shumën e përcaktuar në kontratën e qirasë të cekur më lartë.

Në rrethana të tilla, Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale në këtë rast dispozitat nga neni 17 paragrafi 1 të LMD - së, me të cilin është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrën e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, si dhe nenin 262 paragrafi 1 të po këtij ligji është paraparë që: *“Kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në frymën e këtyre dispozitave rezulton se me të drejtë është aprovuar kërkesëpadia e paditëses, kjo pasi që nga shkesat e lëndës ka rezultuar se e paditura nuk ka kryer plotësisht pagesat si rezultat i shfrytëzimit të depos, për çka edhe gjykatat me të drejtë kanë gjykuar shumën e borxhit të lartcekur për pagesë. Kjo gjykatë vlerëson se detyrimi i të paditurës derivon nga raporti kontraktues - kontrata e qirasë, respektivisht vazhdimi në mënyrë të heshtur i kontratës, edhe pas vitit 2009, në bazë të cilit rezulton se me vet shfrytëzimin e objektit e deri në momentin e njoftimit e paditura, është përgjegjëse në obligimin e kompensimit të borxhit në shumën e përcaktuar si në ekspertizën financiare.

Në anën tjetër, e paditura me revizionin e paraqitur ka bashkëngjitur edhe procesverbalin për mbylljen e deposë nr.03-629, të datës 11.03.2014 të paditëses, si dhe kallëzimin penal PPN.Nr.361/2016, të datës 21.12.2016, të bërë paditëses, së bashku me urgjencat për shpejtimin e procedurës në Prokurori, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se provat e paraqitura në këtë fazë të procedurës nuk mund të parashtrohen, për shkak se referuar dispozitës së nenit 216 të LPK-së së ndryshuar, përkatësisht neni 10 i këtij ligji, provat e reja mund të parashtrohen me revizion, vetëm nëse kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë dhe të njëjtat palët pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti paraqesin më herët, gjë që në rastin konkret nuk janë evidentuar shkelje të tilla. Për më tepër, të njëjtat nuk janë me ndikim për çështjen në rastin konkret, pasi në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë vendim nga ana e gjykatës që e paditura, apo personi përgjegjës i saj të jetë dënuar për falsifikim të dokumenteve zyrtare, apo ndonjë vepër tjetër penale. Nëse eventualisht në të ardhmen e paditura siguron një aktgjykim të tillë të formës së prerë, atëherë e njëjta edhe ka mundësi të përdorë mjetet juridike të përcaktuara me LPK, për raste të tilla.

Gjykata Supreme ka vlerësuar edhe pretendimin në revizionin e palës së paditur, që sipas saj ka të bëjë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 257.1 dhe 258 të LPK-së, pasi që ndryshimi i padisë së paditëses është bërë në kundërshtim me këto dispozita ligjore, mirëpo ka ardhur në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të cekura më lartë,

pasi që ndryshimi i padisë nga pala paditëse është bërë në seancën përgatitore të mbajtur me datë 18.05.2016, për çka edhe në këtë rast është vepruar në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 258 paragraf 1 të LPK-së.

Përveç kësaj, kjo gjykatë ka vlerësuar edhe pretendimin e paraqitur në revizion lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, mirëpo erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës rezulton se paditësja padinë ndaj të paditurës e ka dorëzuar në gjykatën e shkallës së parë me datë 13.11.2006, me objekt të padisë pagimin e qirasë për depon kontestuese, ndërsa gjatë zhvillimit të procedurës është bërë precizimi i kërkesëpadisë për lartësinë e kërkesëpadisë, në raport me periudhën 2007-2014, që do të thotë se në këtë rast kemi vazhdimësi të kërkesës së paditëses ndaj të paditurës, pasi që parashkrimi është ndërprerë me rastin e parashtrimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë, konform dispozitës së nenit 388 të LMD-së së vitit 1978.

Gjykata Supreme vlerësoj edhe pretendimet tjera për shkelje të së drejtës materiale, respektivisht shkelje të dispozitave të LMD-së, LPP-së, LPK-së, Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe shkelje të konventave ndërkombëtare, mirëpo vlerësoj se pretendimet për shkeljet e tilla ishin të përgjithësuara dhe të njëjtat nuk vërtetonin shkeljet e pretenduara, si dhe nuk patën ndikim në marrjen e vendimit.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur nga pala e paditur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi, duke i marr për bazë edhe të gjitha të gjeturat e Gjykatës Kushtetuese në aktgjykimin KI36/23, datë 28 tetor 2024.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.48/2024, datë 04.02.2025

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Lumni Sallauka